



Pranuar / Dorezuar Prilbena / Prilbato Received / Delivery	29. 11	2023	3	viti god year
Organ / Shkronja Org / Unit	In Pret Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRSHICK	7095/2023		117	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1208/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1208/2023, të datës 26.09.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit: Avokatura Shtetërore-Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike „masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.11.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1208/2023, e datës 26.09.2023, e parashtruar nga ankuesja.
- II. Anulohet** masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” e datës 05.09.2023, e shqiptuar ndaj ankueses nga zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetërore.
- III. Obligohet** Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e ankueses dhe regjistri përkatës, masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”, e anuluar si në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (tutje vetëm ankuesja), më datë 26.09.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1208/2023, kundër masës disiplinore “vërejtje me shkrim” të shqiptuar me datë 05.09.2023, nga

Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetërorë, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 11.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 6914/2023, të datës 07.11.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1208/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 26.09.2023 me numër protokollit 6250/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim të datës 05.09.2023; Komunikimet elektronike të datës 17.08.2023 dhe 24.07.2023 ndërmjet ankueses dhe zëvendësues së Avokatit të Përgjithshme Shtetërorë; Vendimin me Nr.18/2022 të datës 30.03. 2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 11.08.2023; Raportin për seanca për periudhën nga data 14.08.2023-18.08.2023 nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërorë; Aktvendimin me numër C.nr.1246/19 të datës 14.08.2023 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm; Padinë e datës 08.06.2007 e parashtruar nga M.G; Kërkesën e datës 05.09.2023 të parashtruar nga ankuesja përmes e-mailit zyrtar ndaj B.K; Deklaratën e datës 07.09.2023 e parashtruar nga B.K; Kërkesën e datës 15.09.2023 të parashtruar nga ankuesja përmes e-mailit zyrtar ndaj I.A; Kërkesën e datës 15.09.2023 të parashtruar nga I.A përmes e-mailit zyrtar ndaj ankueses; Kërkesën e datës 17.08.2023 të parashtruar nga ankuesja përmes e-mailit zyrtar ndaj B.K de I.A; Procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 14.08.2023 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë me numër R.nr.62/22; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.10.2023 nga Ministria e Drejtësisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimin e ankueses të datës 03.11.2016; Vendimin me Nr.10-4025/3 të datës 03.11.2016 të Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror; Vendimin me Nr.159/2016 të datës 18.10.2016 të Ministres së Drejtësisë; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë ligjor në Divizionin për Përfaqësim Gjyqësor dhe Konkursin me numër të Referencës të datës 27.06.2023 si dhe Vendimin me numër protokollit 6914/2023 të datës 07.11.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankueses në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale Kolegji ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Avokaturën Shtetëror në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe se e njëjta sipas Aktit të emërimit të datës 03.11.2016, ushtron pozitën e punës “Avokat shtetëror”.

Me datë 05.09.2023, Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetërore, në cilësinë e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankueses, përmes e-mailit zyrtar ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore “Vërejtje me shkrim“, me arsyetimin se e njëjta përkundër kërkesës së datës 27.07.2023, i ka dhënë për përfaqësim lëndët avokates shtetërore znj. Ilire Aydogan, pasi që ndaj kësaj të fundit është iniciuar procedurë disiplinore, dhe po ashtu në kundërshtim me kërkesat e Zëvendës Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, është lidh ujdë gjyqësore nga avokati që nuk ka qenë i ngarkuar me lëndë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se masa disiplinore e kundërshtuar me ankesë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Shton se zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror ka qenë e njoftuar për secilën lëndë të përfaqësuar nga ana e saj, vërejtja i është dhënë vetëm për shkak së ankuesja ka bartë për përfaqësim lëndën avokates shtetërore Ilire Aydogan, me pretendimin se ndaj të njëjtës është iniciuar procedurë disiplinore, edhe pse ndaj kësaj të fundit nuk ka pasur vendim nga Komisioni Disiplinor e që si avokat shtetëror nuk mund të paragjykojmë për përfundimin e një procedure të iniciuar qoftë disiplinore apo gjyqësore. Tutje shton se lëndën të cilën i’a ka dhënë kolegut Av. Bedri Krasniqit për përfaqësim, prej nga ky i fundit të njëjtën pa dijeninë e ankueses i ka kaluar për përfaqësim tek av. Ilire Aydogan, dhe se nuk ka qenë i informuar lidhur e-mailin e dërguar të datës 24.07.2023 nga zv. Avokatja e Përgjithshme. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj masën disiplinore vërejtje me shkrim të datës 05.09.2023 si dhe të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Në kuptim të pranueshmërinë së ankesës, Kolegji i ‘u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës konstaton se ankesa A.nr.1208/2023 është e pranueshme, mbi bazën se ankuesja ka legjitimitetin e palës për të ushtruar ankesë, ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1, të LPPA-së, dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion për trajtimin e kësaj çështje juridiko-administrative, ashtu siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërlidhur me paragrafin 2 i cili parasheh se: ”2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.....”, dhe Ligjin Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku parasheh:”1.1.Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil“.*

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkitazi me disiplinën në shërbimin civil, me theks të veçantë :

- **Nenit 45:** Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.

- **Nenit 46:** Shkeljet disiplinore 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

- **Neni 47:** Masat disiplinore 1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil.

- **Neni 48:** Kompetenca dhe procedura disiplinore 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor. 4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtarit të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore....

- **Neni 49:** Krijimi dhe përbërja e komisionit disiplinor 1. Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse.

- **Neni 50:** *Parimet e individualizimit të masave disiplinore* 1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore.

Për më tepër, për vendosje të drejtë dhe meritore, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e nenit 10 të Ligjit Nr.04/L-157 Për Avokaturën Shtetërore, me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: 1. Avokatët shtetëror për punën e tyre i përgjigjen Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror. 2. Avokatët shtetëror e informojnë Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror për gjendjen e përfaqësimit të lëndëve. 3. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror ua ndan detyrat avokatëve shtetërorë, dhe iu jep udhëzime të përgjithshme lidhur me kryerjen e detyrave në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Avokaturës Shtetërore. Në kuptim të këtij ligji, udhëzimet për punën e avokatëve shtetërorë përfshijnë drejtimitet e përgjithshme lidhur me kryerjen e detyrave dhe të aktiviteteve, si dhe orientimet për ndërmarrjen e procedurave dhe të masave në rastet konkrete. 4. Në kryerjen e punëve të përfaqësimit, Avokatura Shtetërore është e autorizuar që të ndërmarr të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr pala në procedurë, në pajtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovë.....”

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, Kolegji ka analizuar aktin e shqiptimit të masës disiplinore të kundërshtuar më ankesë dhe si rrjedhojë konstatoi se shqiptimi i kësaj mase është bërë vetëm mbi bazën e nenit 48 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, normë kjo që përcakton kompetencën e organeve për shqiptimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë, rrjedhimisht Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të kontestuar nuk ka bërë kualifikimin e shkeljeve të pretenduara të ankueses. Në këtë kontekst, Kolegji thekson faktin së përcaktimi i natyrës së shkeljes është bazë për përcaktim të kompetencës lëndore si dhe shqiptimin e masës disiplinore të duhur në raport me shkeljen disiplinore.

Kolegji, po nga analizimi i shkresave të lëndës vlerëson së Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses e goditur me ankesë, nuk ka arritur të argumentoj se në veprimet e ankueses ekzistojnë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç përcaktohet me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse, sipas provave materiale rezulton se ankuesja bazuar në praktikën e motshme të aplikuar në Avokaturën Shtetërore, praktikë kjo që me asnjë provë nuk e është kontestuar asnjëherë nga Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, ka bart tek avokati shtetëror Bedri Krasniqi për përfaqësim lëndën jo kontestimore CN.nr.62/22, pasi që i njëjti në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, me datë 14.08.2023, ka qenë në përfaqësim edhe për disa lëndë të tjera (për të cilat ka qenë i ngarkuar) dhe se për arsye të lodhjes dhe temperaturave të larta lëndën CN.nr.62/22, e ka kaluar tek avokatja Ilire Aydogan, e cila po në të njëjtën ditë ka qenë duke përfaqësuar lëndët e saj pranë kësaj gjykate. Rrjedhimisht, bazuar në vet sqarimet e ankueses në ankesë të konfirmuara edhe nga avokati Bedri Krasniqi në deklaratën me shkrim të datës 07.09.2023, si dhe të avokates Ilire Aydogan në deklaratën e datës 15.09.2023, konstatohet se lënda CN.nr.62/22, i

është dhënë avokates Ilire Aydogan, nga avokati Bedri Krasniqi e jo nga ankuesja dhe se ankuesja nuk ka mundur të jetë në dijeni për këtë fakt, pasi që kalimi i lëndës për përfaqësim ishte bërë gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore.

Ndërlidhur me këtë konstatim Kolegji iu referua deklaratës të datës 07.09.2023, të avokatit shtetëror Bedri Krasniqi, i cili ndër të tjera ka cituar: “ ... vërtetohet se lëndët C.nr.62/22 ku propozues ishte Milan Filipovic dhe Cn.nr,06/23 ku propozues ishte Baki Beqiri, i kam pranuar nga ju av. Naime Abazi. Po ashtu deklaroj se me .dt.15.08.2023 kam përfaqësuar deri në ora 11.00h, mirëpo për shkak të lodhjes meqenëse kisha mbajtur 4-5 seanca si dhe temperaturës së lartë, në sallën ku po mbaheshin seancat nuk munda të vazhdoj me tutje dhe pasi që në gjykatë erdhi kolegia zv. Ilire Aydogan për seancën e lëndës së saj dhe për shkak se nuk ndihesha mirë për shkak të lodhjes dhe nxehtësisë së sallës së gjykimit, Ilires ne prani të gjyqtarës Mitra Dimic ia dhashë edhe lëndën për të cilën ngarkohej av. cila po me datë 14.08.2023 kishte shkuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për të përfaqësuar në një lëndë tjetër (të vjetër të kthyer në rigjykim për disa herë. Edhe një herë më përgjegjësi dhe ndërgjegje të plotë, konfirmoj se lëndën e e propozuesit Baki Beqiri ia kam dhënë avokatës Ilire Aydogan pa dijeninë e av. gjithnjë duke u nisur nga praktika brenda AVSH-së, e cila ka funksionuar në këtë mënyrë,... E po ashtu deklaroj se nuk kam qenë në dijeni se zv.Avokatja e Përgjithshme Shtetërore Fitore Gajtani me ua paska ndalur juve dhe av.Nazmije Aliu, që ti jepni lëndë për përfaqësim av.Ilire Aydogan për shkak se ndaj saj qenka iniciuar procedura disiplinore”, Ndërsa, avokatja Ilire Aydogan përmes e-mailit zyrtar të datës 15.09.2023, lidhur rastin ka sqaruar, citojmë: “....av.Bedri Krasniqi po ashtu ka vepruar konform ligjit me lëndën time, por pasi që unë arrita në Gjykatë i njëjti mu drejtua që të vazhdoj me lëndën time dhe më një lëndë tjetër e cila si provë kishte pajtimin gjyqësor të lidhur në këtë gjykatë nga unë për një rast të ngjashëm, duke më thënë a mund të vazhdosh pasi që nga ora 09:00 jam në Gjykatë dhe jam jashtëzakonisht i lodhur, siç kam vepruar unë dhe gjithë avokatët shtetëror tani e 15 vite, për të i dalë në ndihmë njëri tjetrit pasi që është e pamundur që avokati shtetëror të i mbërrijë të gjitha seancat ditore në teren e të ndryshme, njëjtë veprova edhe atë ditë.....

Për më tepër, Kolegji sipas e-mailit të datës 24.07.2023 të Zëvendësueses së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, ka konstatuar se kjo e fundit kishte kërkuar vetëm nga avokatët shtetëror N. Aliu dhe N. Abazi, këtu ankuesja, që mos ti japin lëndë për përfaqësim avokates Ilire Aydogan, pasi që ndaj të njëjtës është iniciuar procedurë disiplinore, pra lidhur me këtë fakt, gjegjësisht mos bartjen e lëndëve për përfaqësim tek avokatja Ilire Aydogan, nuk kanë qenë në dijeni avokatët e tjetër shtetëror, andaj, edhe mbi këtë bazë rezulton së bartja e lëndës jokontetsimore C.Nr.62/22 nga avokati Bedri Krasniqi tek avokatja Ilire Aydogan dhe lidhja e ujdise gjyqësore nga kjo e fundit lidhur me këtë lëndë nuk e bënë përgjegjës as avokatin B.Krasniqi dhe as ankuesen, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë tërësisht të bazuara.

Përkitazi me pretendimin e Zëvendësueses së Avokatit të Përgjithshme për lidhje të ujdive gjyqësore pa miratim dhe aprovim paraprak të saj, Kolegji rithekson faktin se: me Vendimin A.nr.1206/2023, të datës 08.11.2023, Këshilli ka trajtuar meritorisht çështjen e bartjes së lëndëve në mes të avokatëve shtetëror, duke konsideruar si fakt të pa kontestueshëm një praktike të tillë, pasi që institucionet kanë në diskrecion të tyre të drejtën e vendosjes së procedurave të menaxhimit ekonomik dhe efikas të detyrave të punës, praktikë kjo që sipas shkresave të lëndës zbatohet me vite në Avokatorën Shtetërore, mirëpo, lidhja e ujdive gjyqësore pa diskutim dhe miratim nga Avokati i Përgjithshëm Shtetërore dhe përkundër

kërkesës së kësaj të fundit, duhet të trajtohen mbi baza të përgjegjësisë individuale, e që në rastin konkret lidhja e ujdisë gjyqësore në lëndën Cn.nr.62/22, nuk është bërë nga ankuesja.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenet 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Theksuar si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1208/2023

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Zëvendësueses së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.